



Qendra e
Studimeve
Parlamentare

BULETIN

www.ascpdp.org



Ambasada Britanike
Tiranë

Transparenca dhe Pjesëmarrja në Veprimtaritë Legjislative INTEGRIMI NË BE

Buletin informativ Nr.4

korrik 2006

Kuvendi i Shqipërisë miratoi Projektligjin “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit”

Më datë 27.07.2006 Kuvendi i Shqipërisë miratoi Projektligjin “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e Shteteve të tyre Anëtare”

Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit (MSA) është instrumenti, i cili do të mundësojë integrimin gradual të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, si dhe krijon kuadrin e duhur për forcimin e shtetit ligjor në Shqipëri, rritjen e efikasitetit të tij, ndihmon reformat institucionale dhe ekonomike, për rritjen e standardeve të jetesës për të gjithë shtetasit shqiptarë.

Me anë të kësaj marrëveshjeje Republika e Shqipërisë bëhet shtet i asociuar i Bashkimit Europian dhe konfirmohet statusi i saj si vend kandidat potencial për aderim në BE.

Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit i njeh Republikës së Shqipërisë dhe shtetasve të saj detyrimet dhe të drejtat si më poshtë vijon:

1. Respektimi i shtetit të së drejtës dhe i demokracisë, i të drejtave të njeriut dhe

(vijon në faqen 2)

Déjà vu

Këshilli i Ministrave miratoi së fundmi Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (më poshtë PKZ-MSA), si përgjigje e zhvillimeve të fundit që po kalon vendi ynë në kuadër të procesit të integritit europian. Sipas njoftimit për shtyp të Ministrisë së Integritit Europian, plani është përgjigje e Vendimit të Këshillit të BE-së “Për parimet, përparësitë dhe kushtet e përmbajtura në Partneritetin Europian me Shqipërinë”, miratuar në janar të vitit 2006.

Duke prezumuar faktin se procesi i hartimit të planit është udhëhequr nga një metodologji në lidhje me hartimin, objektivat politikë, afatet, synimin dhe priorizimin e elementeve dhe instrumenteve thelbësorë të procesit, në përputhje me stadin aktual të marrëdhënieve Shqipëri-BE, sidomos pas firmosjes së MSA-së, mënyrën e përlogaritjes së kapaciteteve administrative dhe kostos financiare të nevojshme për zbatimin e MSA-së, mënyrën e për-

(vijon në faqen 5)

Në këtë numër:

1. Kuvendi i Shqipërisë ratifikon Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit
faqe 1-5

2. Nga Veprimtaria e Komisionit Parlamentar të Integritit korrik 2006

faqe 1,5-6

3. Déjà vu
Ditmir Bushati faqe 1,5-7

4. Nga punimet e Kuvendit për muajin korrik 2006
faqe 8-9

5. Ligje të miratuara gjatë punimeve të sesionit të dytë të Kuvendit në Legjislaturën e XVII.
faqe 10-15

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN KORRIK 2006

Komisioni i Integritit për muajin korrik ka patur aktivitete të ndryshme në lidhje me fushën e kompetencës së tij. Këto veprimtari mund të ndahen në:

Veprimtaria legjislative

Gjatë muajit korrik, Komisioni i Integritit ka shqyrtuar disa projektligje. Kryesisht projektligjet konsideronin ratifikimet nga Parlamenti shqiptar i disa marrëveshjeve ndërkombëtare, titujt e të cilëve vijojnë më poshtë:

1. Projektligji :” Për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit, ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin “modernizimi i sistemit shëndetësor”.

2. Projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë, për transportin ndërkombëtar rrugor”.

(vijon në faqen 4)

Kuvendi i Shqipërisë miratoi Projektligjin “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së

Stabilizim - Asociimit”

(vijon nga faqja 1)

minoriteteve, si dhe i rregullave të një ekonomie të lirë tregu.

Respektimi i parimeve demokratike dhe i të drejtave të njeriut, i shtetit ligjor dhe i lirisë ekonomike duhet të përbëjnë bazat e politikave të shtetit shqiptar. Ky detyrim vlerësohet si klauzolë thelbësore e marrëveshjes, shkelja e të cilit mund të justifikojë masa, që shkojnë deri në pezullim ose anulim të marrëveshjes. Shqipëria duhet të mbrojë në vazhdimësi dhe në mënyrë efektive, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, për të shkuar drejt integritetit evropian.

2. Bashkëpunimi rajonal, në favor të stabilitetit dhe të zhvillimit ekonomik.

Bashkëpunimi rajonal ka të bëjë me forcimin e marrëdhënieve, politike dhe ekonomike, me anë të marrëveshjeve dypalëshe, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të rajonit, në të gjitha fushat, që mbulon marrëveshja. Ky instrument do të mundësojë forcimin e paqes sociale dhe zhvillimin ekonomik në rajon, duke zbatuar rregullat europiane të një tregu të hapur, të mbështetur në struktura efektive dhe duke respektuar rregullat e konkurrencës së lirë.

3. Krijimi i një zone tregtie të lirë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

Lëvizja e lirë e mallrave, së bashku me dispozitat që parashikojnë lëvizjen e lirë të personave, shërbimeve dhe kapitaleve, përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë evropian dhe bashkëpunimi në fushat parësore të zhvillimit social-ekonomik të vendit hapin rrugën drejt krijimit, në të ardhmen, të një tregu të përbashkët, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

Zona e tregtisë së lirë Shqipëri - BE

Për vendosjen graduale të një zone tregtie të lirë, ku mallrat qarkullojnë lirshëm, palët, në bazë të MSA-së, angazhohen të shmangin detyrimet doganore, kufizimet sasiore dhe masat me efekt të njëjtë me to, të ndalojnë adoptimin e barrierave të reja tregtare, si dhe të respektojnë parimin e mosdiskriminimit, ndërmjet mallrave të palëve kontraktuese, në fushën fiskale.

Asimetria në zbatimin e MSA-së

Duke patur parasysh konkurrencën e dobët të produkteve me origjinë shqiptare, me hyrjen në fuqi të marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit, hapja e menjëhershme e tregut shqiptar do të kishte pasoja të dëmshme për ekonominë e vendit. Gjithashtu, duke patur parasysh se qëllimi i MSA-së është vendosja e stabilitetit, politik dhe ekonomik, në shtet dhe asociuar, zona e tregtisë së lirë Shqipëri - BE, parashikohet të realizohet gradualisht dhe në mënyrë asimetrike, për një periudhë 10-vjeçare. Për të vendosur zonën e tregtisë së lirë, BE-ja bën lëshime ndaj Republikës së Shqipërisë për shmangien graduale të tarifave doganore apo të kufizimeve sasiore për mallrat e importuara, me origjinë komunitare, të cilat reduktohen progresivisht deri në shmangien e plotë të tyre. BE-ia i ka hequr pothuajse krejtësisht detyrimet doganore dhe kufizimet e tjera për importin e mallrave shqiptare në territorin komunitar. Nga ky regjim i favorshëm për vendin tonë eksportuesit shqiptarë do të kenë më tepër akses në tregun evropian dhe do të mund të rrisin eksportet e tyre për në BE, me kosto më të ulët se deri tani. Për shkak të heqjes së barrierave tarifore dhe sasiore edhe konsumatorët shqiptarë do të ndjejnë efekte pozitive në uljen e çmimit të mallrave të importuara dhe të atyre vendase, të cilat duhet të përshtaten në cilësi dhe çmim me kushtet e reja. Për mbrojtjen e ekonomisë së shtetit të asociuar, MSA-ja vë në dispozicion të tij

masa mbrojtëse tregtare, për rastet kur importet shkaktojnë ose kërcënojnë t'i shkaktojnë dëme të mëdha prodhuesve vendas apo shqetësime serioze një sektori të ekonomisë apo një rajoni. Mbrojtja e rendit, sigurisë dhe shëndetit publik justifikon marrjen e masave kufizuese në lëvizjen e lirë të mallrave.

BE-ja bën lëshime edhe në fushat kyçe të realizimit të zonës së tregtisë së lirë, kryesisht, në fushën e ndihmave shtetërore dhe të prokurimeve publike, për zvogëlimin e diferencave ekonomiko-shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, zhvillimin e ndërmarrjeve shqiptare dhe rritjen e aftesisë së tyre konkurruese në tregun rajonal e evropian, si dhe rritjen e investimeve dhe të prodhimit në vend.

Lëvizja e lirë e personave, shërbimeve dhe kapitaleve

Në bazë të marrëveshjes, një shtetas shqiptar do të mund të lëvizë lirshëm në territorin evropian, nëse ai ushtron të drejtën e lëvizjes së punëtorëve ose të drejtën e vendosjes në njërin nga shtetet anëtare të BE-së ose anasjelltas.

a) Lëvizja e lirë e punëtorëve

MSA-ja parashikon parimin e trajtimit kombëtar, sipas së cilit punëtori shqiptar, ligjërisht i punësuar në territorin e një shteti, anëtar të BE-së, duhet të trajtohet si shtetasi i po këtij shteti, anëtar i BE-së, përsa u përket kushteve të punës, të pagës ose të pushimit nga puna.

Gjithashtu, bashkëshorti dhe fëmijët e një punëtori të punësuar ligjërisht në territorin e një shteti, anëtar të BE-së, kur banojnë ligjërisht në këtë shtet, kanë të drejtën e arsimimit dhe të aksesit në tregun e punës së këtij shteti gjatë periudhës së qëndrimit të autorizuar të punëtorit. Aksesit për punësim i punëtorëve shqiptarë në tregun evropian është i kufizuar, pasi mbetet në vullnetin e shteteve anëtare të BE-së, të cilat e njohin lirinë e lëvizjes së punëtorëve me anë të marrëveshjeve dypalëshe, që nënshkruhen me Republikën e Shqipërisë.

b) E drejta e vendosjes

E drejta e vendosjes, e cila lidhet drejtpërdrejt me investimet e huaja, realizohet me anë të ushtrimit të një veprimtarie afatgjatë profesionale nga një shtetas shqiptar në një vend anëtar të BE-së, si i vetëpunësuar ose duke krijuar a drejtuar një ndërmarrje. Dispozitat e MSA-së i njohin të drejtën e vendosjes edhe shoqërive, nëpërmjet ngritjes së tyre apo vendosjes së degëve të shoqërive në territorin evropian.

Për personat fizikë ushtrimi i kësaj lirie është i kufizuar. Vetëm pas një periudhe tranzitore, pas hyrjes në fuqi të MSA-së, këto të drejta mund t'u njihen personave fizikë, që ushtrojnë veprimtari ekonomike si të pavarur.

Sipas marrëveshjes, shoqëritë, degët a filialet e shoqërive shqiptare gëzojnë një trajtim jodiskriminues dhe të njëjtë me shoqëritë europiane, pas hyrjes në fuqi të saj.

c) Liria e ofrimit të shërbimeve

Liria e ofrimit të shërbimeve është një mundësi, që do t'i njihet çdo shtetasi shqiptar, për të ofruar dhe realizuar shërbime, në mënyrë të përkohshme në territorin evropian ose në territorin e tij, pranë shtetasve të BE-së. Realizimi i lëvizjes së lirë të shërbimeve kërkon, që palët të marrin masat e nevojshme, për të lejuar progresivisht ofrimin e shërbimeve nga shoqëritë ose shtetasit e tyre.

ç) Kapitale dhe pagesat

Lëvizja e lirë e kapitaleve është vazhdimësi e lëvizjes së lirë

(vijon në faqen 3)

Kuvendi i Shqipërisë miratoi Projektligjin “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit”

(vijon nga faqja 2)

të mallrave dhe të vendosjes. Republika e Shqipërisë dhe BE-ja duhet të sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitaleve për investimet e drejtpërdrejta, investimet në përgjithësi, si dhe për kreditë për transaksionet tregtare.

4. *Adoptimi i Acquisi communautaire*

Republika e Shqipërisë duhet të adoptojë ç’ka është realizuar, në kuadër të Bashkimit Europian.

MSA-ja çon drejt aderimit të plotë në BE dhe si e tillë ajo i imponon Republikës së Shqipërisë të integrojë në sistemin e saj juridik *Acquisi communautaire*, duke përfunduar gradualisht legjislacionin shqiptar me atë europian.

Qëllimi i përafrimit të legjislacionit është krijimi i një kuadri, ligjor dhe institucional, që do të lejojë tregun shqiptar të integrohet në tregun e brendshëm europian me synimin primar të përfitimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetasve shqiptarë. Përafrimi i legjislacionit parashikohet të bëhet në dy faza sipas një programi të hollësishëm. Gjatë fazës së parë të periudhës tranzitore prej pesë vjetësh, përafrimi i legjislacionit do të mbulojë disa elemente themelore të *acquisi communautaire*, në fushën e tregut të përbashkët, që kanë të bëjnë me vendosjen e konkurrencës së lirë dhe të ndershme, mbrojtjen e pronësisë tregtare, industriale dhe intelektuale, standartizimin, akreditimin dhe certifikimin e cilësisë së mallrave, prokurimit publik dhe mbrojtjes së konsumatorit.

5. *Bashkëpunimi në fushën e drejtësisë dhe të çështjeve të brendshme e politikave të tjera sektoriale.*

Bashkëpunimi në fushat e drejtësisë dhe të çështjeve të brendshme përbën një tjetër detyrim të marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe ka si qëllim krijimin e një hapësirë lirie, sigurie dhe drejtësie të Shqipërisë dhe BE-së.

Ky bashkëpunim kërkon që Republika e Shqipërisë të forcojë institucionet, në çdo nivel, por në veçanti ato që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe administrimin e drejtësisë. Pikat kyçe të këtij bashkëpunimi fokusohen në regjimin e vizave, azilit dhe migracionit, dhe në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Lëvizja e lirë e shtetasve shqiptarë në hapësirën europiane është e lidhur ngushtë me progresin e arritur në këto fusha.

Bashkëpunimi në politika të tjera sektoriale, me natyrë ekonomike dhe shoqërore, ka si objekt përkrahjen dhe zhvillimin e shtetit të asociuar dhe forcimin e marrëdhënieve ekonomike ekzistuese ndërmjet palëve.

6. *Bashkëpunimi financiar*

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit parashikon dhënien e një ndihme financiare për shtetin shqiptar, për arritjen e objektivave të vendosura nga marrëveshja. Bashkëpunimi financiar do të mund të mbështesë reformat ekonomike dhe institucionale, të shtetit të asociuar, në përputhje me kërkesat e procesit të Stabilizim-Asociimit.

7. *Procedurat e hyrjes në fuqi*

Sipas nenit 135, të MSA-së palët e ratifikojnë ose miratojnë këtë marrëveshje në bazë të procedurave të veta.

Për palën shqiptare marrëveshja ratifikohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe botohet në “Fletoren zyrtare” të Republikës së Shqipërisë. Për palën komunitare, Këshilli përfundon marrëveshjen pas dhënies së pëlqimit nga Parlamenti Europian. Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas ratifikimit nga parlamentet e secilit vend anëtar të Bashkimit Europian.

Instrumentet e ratifikimit dhe të miratimit depozitohen te Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Europi-

an. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë, pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose miratimit.

Shtojcat dhe protokollet

Pjesë e rëndësishme, përbërëse e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit janë edhe shtojcat dhe protokollet, të cilat kanë po atë fuqi juridike për palët si dhe vetë marrëveshja Shtojcat

Shtojca I - Koncesione tarifore të Shqipërisë për produktet industriale të Komunitetit;

Shtojca II (a) - Tarifat koncesionare shqiptare për prodhimet primare bujqësore, të prodhuara në komunitet referuar nenit 27 (3) (a);

Shtojca 11(b) - Tarifat e koncesioneve shqiptare për produktet kryesore bujqësore të prodhuara në Komunitet referuar nenit 27 (3) (b);

Shtojca II (c) - Tarifat koncesionare shqiptare për produktet bazë bujqësore, të prodhuara në Komunitet referuar nenit 27 (3) (c);

Shtojca III - Tarifat koncesionare të KE-së për peshkun dhe nënproduktet e peshkut shqiptar;

Shtojca IV - (Neni 49) - Vendosja : Shërbimet financiare;

Shtojca V (Neni 73) - Të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.

Protokollet

Protokolli 1: Për prodhimin e hekurit dhe çelikut;

Protokolli 2: Për tregtinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit në sektorin e produkteve bujqësore, të përpunuara;

Protokolli 3: Për koncesionet preferenciale të ndërsjella, për disa lloje verërash, njohja e ndërsjellë dhe kontrolli i verërave, pijeve alkoolike dhe emrat e verërave të aromatizuara;

Protokolli 4: Përkufizimi i konceptit “Produkte origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ;

Protokolli 5: Për ndihmën e ndërsjellë administrative në çështje doganore.

Ministria e Integritetit është autoriteti përgjegjës për bashkërendimin e punës dhe për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN KORRIK 2006

(vijon nga faqja 1)

3. Projektligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për aspekte të caktuara të shërbimeve ajrore"

Veprimtaria monitoruese

Në kuadrin e veprimtarisë monitoruese të Komisionit të Integrimin, është marrë në shqyrtim paketa fiskale që Qeveria ka sjellë për miratim në Kuvend sipas procedurave të parashikuara në Kushtetute dhe në Rregulloren e brëndshme të Kuvendit. Për diskutimin e saj është ftuar të raportojë pranë Komisionit në një seance dëgjimore, Z. Florian Mima, Zëvendësministër i Ministrisë së Financave.

Gjatë këtij takimi është diskutuar mbi pikat e ndryshme të kësaj pakete fiskale, sikurse janë diferenca e skemave të TVSH¹, bashkimi i tatimeve dhe doganave, kontrolli i evazionit fiskal, pronësia intelektuale, sigurimet shoqërore, aksizat, thjeshtimi i procedurave të rregjistrimit dhe çështje të tjera të parashikuara në paketën fiskale. Komisioni i Integrimit kërkoi shpjegime lidhur me referimet në marrëveshjen e përkohshme mbi tregtinë dhe bashkëpunimin tregtar ndërmjet Komunitetit Europian nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër² që pritet të ratifikohet nga Kuvendi i Shqipërisë së shpejti pasi kanë filluar procedurat për kalimin e saj në procedurat e miratimit të ligjeve.

Veprimtari këshilluese në takime dypalëshe.

Komisioni për Integrimin Europian ka zhvilluar një takim me Ambasadorin Gjerman Hans-Peter Annen me rastin e marrjes së Presidencës së rradhës të Këshillit Europian nga Finlanda dhe pas kësaj Presidencë i përket Gjermanisë. Ambasadori gjerman shpjegoi linjat e përgjithshme të kësaj Presidencë dhe vuri në dukje vazhdimësinë që do të ketë ndërmjet Austrisë, Finlandës dhe Gjermanisë në politikën europiane.

Duke konsideruar dështimin e Kushtetutës të Bashkimit Europian gjatë referendumit në Francë dhe në Holandë, një ndër prioritetet e kësaj presidencë (Finlandës), sipas z. Annen, do të jetë e ardhmja e institucioneve europiane, dhe ndryshimet që ato duhet të kenë, për t'i përballuar sfidat e kohës dhe kompetitivitetit në fushën ndërkombëtare. Presidencë europiane synon të përmirësojë raportin dhe marrëdhëniet ndërmjet Bashkimit Europian dhe qytetarëve për të qenë sa më pranë tyre në bazë të parimit të subsidiaritetit.

Gjithashtu, në objektivat e saj, sipas Ambasadorit gjerman, është edhe procesi i vendimmarrjes duke konsideruar numrin e anëtarëve aktual dhe atij që do të jetë me zgjerimin e ardhshëm me hyrjen e Rumanisë dhe Bullgarisë, e parashikuar në janar të 2007. Në kuadrin të zgjerimit, prioritet janë edhe raportet me Kroacinë dhe Turqinë, sipas kritereve të Këshillit Europian të Selani-

kut dhe të Helsinkit. Ambasadori gjerman diskutoi mbi kufijt e Europës të cilët mund të konsiderohen si kufij gjeografik ose kulturor. Kjo do të thotë që zgjerimi i Bashkimit Europian vazhdon të jetë një çështje e hapur pa varësisht numrit të anëtarëve që ka arritur dhe atyre që kanë prespektiva për pjesëmarrje aktive. Në këtë vështërim, duhet konsideruar dhe mbydhja e MSA me Shqipërinë dhe vazhdimi i PSA.

Një çështje tjetër në prioritetet e kësaj Presidencë, siç u evidentua në takim, është tregu global i cili do të fokusohet mbi të gjitha në fushën e kërkimeve.

Një çështje tjetër që do të diskutohet është Kosova. Duke patur parasysh punën e Ahtisaarit për Statusin përfundimtar të Kosovës dhe mundësinë që kjo situatë mund të konkretizohet brënda këtij viti, Bashkimi Europian duhet të diskutojë raportet që kjo organizatë do të ketë me subjektin e ri ndërkombëtar pas përcaktimit të statusit.

Në objektivin e Bashkimit Europian do të jetë edhe Serbia, Mali i zi, dhe Bosnia e Hercegovina.

Përsa i përket Shqipërisë, në vecanti, është e një rëndësie të veçantë mbydhja e MSA-së. Bashkimi Europian do të japë të gjithë mbështetjen e duhur për të vënë sa më mirë në zbatim këtë marrëveshje dhe detyrimet që rrjedhin nga ajo për rritjen e standardeve të jetesës në vend. Bashkimi Europian do të diskutojë mbi tregun e lirë dhe lehtësimin e rregjimit të vizave.

Z. Annen vlerësoi rolin e Parlamentit në këtë proces. Roli i Parlamentit konsiston në miratimin e ligjeve që kanë për bazë reformat që nevojiten për përmirësimin e standardeve. Roli i Komisionit për Integrimin Europian, në vecanti, duhet të jetë nxitës i reformave.

Kryetari i komisionit, duke falenderuar Ambasadorin Annen për informacionin mbi prioritetet e Presidencës së Finlandës në Bashkimin Europian, parashitroi disa çështje. Së pari, Z. Meta u përqëndrua në politikën që Bashkimi Europian dhe kryesisht kjo Presidencë ka në lidhje me zgjerimin e mëtejshëm të kësaj organizate, cilat do të jenë prespektivat në lidhje me vendet e Ballkanit perëndimor, dhe në vecanti me Shqipërinë. Duke u bazuar në kriteret e Selanikut, dhe në ato rekomandime që janë dhënë në Salsburg institucionet shqiptare do të përqëndrohen në zgjedhjet lokale të ardhshme, për të cilat Bashkimi Europian duhet të ketë një vëmendje të veçantë.

Në përgjigje të kësaj çështje, Ambasadori këshilloi që këto zgjedhje duhet të kenë standarde europiane, të jenë të lira dhe të barabarta. Shqipëria duhet të ketë parasysh reformat që organizmat ndërkombëtare kërkojnë për zbatimin e parimeve të përgjithshme ndërkombëtare për të siguruar një mirëqenie në vend për reformat duhet të

(vijon në faqen 5)

NGA VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PARLAMENTAR TË INTEGRIMIT PËR MUAJIN KORRIK 2006

(vijon nga faqja 4)

përqëndrohen edhe në përbaljen për mbijetesë në një botë tepër konkurruese. Më të tilla reforma po përballet Bashkimi Europian. Pra nuk është vetëm një çështje e Shqipërisë por një çështje me rreze më të gjerë veprimi. Edhe vetë Gjermania po përballet me reforma.

Filozofia e Bashkimit Europian për këto reforma, dhe ajo që kjo organizatë kërkon është shpirti i konsensusit mes palëve, në rastin e Shqipërisë, mes partive politike. Në vazhdim, anëtarët e Komisionit shprehen shqetësimin e tyre për lehtësimin e vizave, e cila sipas praktikave të fundit (shtrengim i vizave) nuk po shkon në të njëjtën linjë me luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar që Qeveria ka ndërmarrë në përputhje me rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare, të evidentuara në raportet e tyre mbi situatën në Shqipëri.

U kërkua gjithashtu edhe ndihma për ekspertizë për vëniën në zbatim të programeve.

Nga ana tjetër u kërkua mendimi për procesin zgjedhor për zgjedhjet e ardhshme vendore dhe për përgatitjen e listës së votuesve.

Në përgjigje të këtyre çështjeve, Ambasadori Annen u shpreh për rolin që opozita duhet të ketë. Opozita duhet të jetë e fortë në këtë proces dhe e përgjegjshme. Zgjedhjet janë një test i mirë për mbarëvajtjen e procesit të demokratizimit, për t'u vlerësuar nga Bashkimi Europian.

Në përfundim, Ambasadori uroi që ratifikimi i MSA-së të kryhet në kohë sa më të shkurtër dhe poashtu garantoj që Gjermania do të fillojë shpejt procedurat për ratifikimin e saj. Marrëveshja e përkohëshme duhet të japë rezultate konkrete pas hyrjes në fuqi të saj.

Gjithashtu Ambasadori paraqiti, në një material të shkruar, programin e Presidencës dhe ofroi mbështetjen e tij për çfarëdo çështje që mund të paraqitet në Komision.

Në përfundim të takimit, anëtarët e Komisionit, shprehën falenderimet e tyre për takimin dhe kërkuan që këto takime konsultative të jenë më të shpeshta.

Déjà vu

(vijon nga faqja 1)

Ilogaritjes së *acquis communautaire* që do të përkthehet dhe kostos së saj, do të ishte e këshillueshme që vetë plani të shoqërohej me një hyrje sqaruese për elementët e mësipërm si dhe të bëhej publike metodologjia e përdorur.

Kjo, përveçse do të rriste transparencën dhe cilësinë e këtij dokumenti, do t'i mundësonte aktorëve të interesuar në Shqipëri dhe Komisionit Europian, si monitoruesi kryesor i zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga ky plan, të vlerësonin me objektivitet këtë dokument. Në fund të fundit, një hyrje sqaruese do të ishte në vazhdim e dokumenteve të ngjashëm të përgatitur nga qeveria shqiptare dhe vende të tjera të rajonit, ku një praktikë e tillë ka marrë trajtën e një *common sense*.

Siç mund të kuptohet që nga titulli, ky plan synon të adresojë para së gjithash detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja, duke i përkthyer ato në një grup masash dhe veprimesh konkrete të cilat duhet të ndërmerren nga institucionet shqiptare. Masa, të cilat nëse përkthehen në mënyrën e duhur dhe shoqërohen me kostot buxhetore, do të shërbejnë për transformimin europianizues të jetës politike, ekonomike dhe shoqërore në vend. Masa, që para së gjithash kërkojnë një veprim të mirëbashkënduar të qeverisë me aktorë të rëndësishëm si Kuvendi, grupet e interesit, shoqëria civile etj.

Plani është i ndarë në tre pjesë kryesore ku zërthehen në iniciativa të ashtuquajturat kritere të Kopenhagenit. Për secilën nga çështjet e adresuar në plan bëhet një ndarje në tre pjesë ku përfshihet situata aktuale (legjislacioni, kuadri institucional dhe asistencja e përdorur), dhe adresimi i prioritetëve (nisma të reja ligjore dhe aktivitet zbatues për të realizuar këto nisma).

Përpara paraqitjes së situatës aktuale dhe zërthimit të prioritetëve në mënyrë përmbledhëse është vendosur objektivi politik, i cili sanksionon vullnetin e shprehur të qeverisë për të realizuar detyrimet e MSA. Kjo praktikë synon të tregojë gjithashtu koherencën midis zbatimit të këtij plani, programit të qeverisë me prioritetet e përcaktuara nga Bashkimi Europian në dokumentin e Partneritetit Europian.

Plani shtrihet në një periudhë kohore deri në 2012 duke respektuar në të njëjtën kohë prioritet afatshkurtra 2006-2007 dhe prioritet afatmesme 2008-2009 të dokumentit të Partneritetit Europian. Plani është i ndërtuar mbi dy shtylla kryesore:

Pjesa narrative dhe gjashtë anekse.

- Aneksi i parë përfshin iniciativat ligjore së bashku me nivelin e përputhshmërisë që synohet të arrihet me *acquis communautaire*.
- Aneksi i dytë përfshin kostot e përkthimit të *acquis communautaire*, e cila shtrihet për një periudhë kohore deri më 2012.

(vijon në faqen 6)

¹ Tatimi mbi vlerën e shtuar

² Kjo marrëveshje njihet ndryshe si marrëveshja ad Interim

Déjà vu

(vijon nga faqja 5)

- Aneksi tretë parashikon rritjen e numrit të planifikuar të nëpunësve në vite deri më 2012.
- Aneksi i katërt përfshin trajnimet e planifikuara për administratën publike.
- Aneksi i pestë parashikon kostot e planifikuara për infrastrukturën elektronike dhe konsulencë deri më 2012.
- Aneksi i gjashtë përfshin listën e aktiviteteve zbatuese sipas fushave të cilat disa prej tyre shtrihen në periudha kohore deri 2010.

Në fakt, viti 2012 nuk korrespondon me periudhën 10 vjecare të zbatimit të MSA-së të sanksionuar në nenin 6 të marrëveshjes. Në rast se qëllimi kryesor i planit do të ishte identifikimi dhe zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga MSA, atëherë duhej të respektohej pikërisht ndarja në dy periudha 5 vjecare të MSA me theks të vecantë në adresimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Përkohshme. Nga ana tjetër, viti 2012 nuk i përgjigjet periudhës së parashikuar në dokumentin e Partneritetit European.

Megjithëse plani është miratuar në mënyrë që të zbatohen detyrimet e MSA-së ai (plani) nuk citon asnjë dispozitë të marrëveshjes. Sot, më shumë se kurrë MSA duhet të shërbejë si udhërrëfyes për çdo institucion dhe nëpunës të administratës publike. Pavarësisht përcaktimit si vit fundor të 2012, shumica e iniciativave në plan shtrihen deri në 2009. Në mungesë të një sqarimi a metodologjie të përdorur mbetet e paqartë nëse ky diferencim ka të bëjë me prioritetet e Partneritetit European, hyrjen në fuqi të MSA-së apo me mandatin 4 vjeçar qeverisës. Në rast se do t'i referohemi për shembull përditësimit të planit kroat të integritit, i cili u miratua në fillim të vitit 2006, që në hyrje të tij shpjegohet se afatet për zbatimin e masave janë të lidhura ngushtë jo vetëm me afatet e negociuara në MSA dhe prioritetet e Partneritetit European, por edhe me mandatin e qëndrimit në detyrë të qeverisë.

Ky konfuzion shtohet që në "pasqyrën e lëndës" të këtij plani, ku parashikohet një kapitull i veçantë, i cili titullohet "*Aftësia për të përballuar detyrimet e antarësisë në BE*". Zëvendësimi i terminologjisë së ofruar nga Partneriteti European, të titulluar "*standardet europiane*" me terminologjinë e mësipërme, e cila mund të jetë realiste vetëm për një vend kandidat, që gjen pasqyrim kryesisht në programet kombëtare për adoptimin e *acquis*, përveç dëshirës pozitive nuk ka asgjë të përbashkët me stadin në të cilin ndodhet vendi në raport me BE-në, dhe as me këtë dokument, i cili nuk mund të interpretohet në asnjë rrethanë si një program kombëtar për adoptimin e *acquis*. Nëse do të ishte e vërtetë e kundërta, atëherë mënyja e pasqyrës së lëndës do të duhej të pasurohej me një kapitull tjetër për "*forcimin e kapaciteteve administrative*", ose të njohur ndryshe si kriteri i Madridit.

Një nga elementet më thelbësor që kushtëzojnë zbatimin e suksesshëm të planit është llogaritja e kostove për aspekte të ndryshme që lidhen me procesin, vërtetësia e të cilave mbetet për t'u provuar. Kjo pasi nga leximi që i bëhet planit rezulton se përlllogaritjet janë bërë për institucione dhe jo për masa apo çështje, sikundër sugjeron praktika e vendeve më të përparuara në këtë proces dhe Guida e Komisionit European "Për strukturat e nevojshme për implementimin e *acquis*". Në këtë vështrim, pyetja që kërkon përgjigje është: Si janë llogaritur kostot për shtimin e kapaciteteve administrative për masa të ndryshme dhe institucione të ndryshme? Çfarë modelesh ekonometrike janë marrë në konsideratë dhe sa të përafërta janë ato me realitetin politiko-administrativ të Shqipërisë? Si paraqitet raporti ndërmjet kërkesës për shtimin e kapaciteteve administrative dhe programit të qeverisë për një administratë të vogël dhe eficiente?

Hartimi i këtij plani nuk është një praktikë e panjohur për administratën dhe institucionet shqiptare. Testi parë i përgatitjes së këtyre dokumentave u kalua me hartimin e Planit të parë të Veprimit në përgjigje të Prioriteteve të Partneritetit European (2004). Plani i Veprimit përqëndrohej vetëm në prioritetet që kishte përcaktuar Partneriteti i parë European që iu ofrua Shqipërisë si pasojë e Axhendës së Selanikut të vitit 2003. Shikuar në kontekstin e kohës, Plani i Veprimit ishte reflektim i një periudhe të caktuar dhe me gjithë motivimin e administratës publike, asistencën e BE-së, bashkëpunimin e ngushtë me Kuvendin dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile, sërish paraqiste disa mangësi.

Disa nga këto mangësi u riparuan në Planin Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit dhe zbatimit të angazhimeve të MSA-së, i cili përmbledhi në një dokument të vetëm masat e nevojshme për adresimin e angazhimeve të marra nga Shqipëria në kuadër të procesit të Stabilizim Asociimit deri në Maj të vitit 2005. Gjatë hartimit të planit administratata publike u asistua nga rreth 30 ekspertë të vendeve të ndryshme të BE-së dhe po kaq ekspertë shqiptarë, të njohur për kontributin e tyre në disiplina të ndryshme.

Gjatë procesit të hartimit të planit u konsultuan dhe analizuan të gjitha praktikat dhe modelet e ndjekura nga vendet e Europës Qendore dhe Lindore dhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo sipërmarrje nuk kishte për qëllim të huazonte disa modele në realitetin shqiptar dhe as të eksperimentonte një model tërësisht të ri. Përkundrazi, elementi bazë udhërrëfyes ishte pa dyshim stadi i marrëdhënieve Shqipëri-BE. Mbi të gjitha, Plani synonte adresimin e rekomandimeve të Komisionit European sipas të cilit "*gjatë procesit të negociatave, Shqipëria duhet të ndër marrë reformat e nevojshme për të ga-*

(vijon në faqen 7)

Déjà vu

(vijon nga faqja 6)

*rantuar që, pas përfundimit të negociatave, ajo do të jetë në gjendje të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit*².

Duke prezumuar faktin se procesi i negociimit të MSA kishte arritur pikën fundore dhe duke ndjerë në të njëjtën kohë nevojën e pasjes së një dokumenti planifikues për procesin e përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis communautaire* shtyllat kryesore ku mbështetej filozofia e hartimit të Planit ishte kombinimi i detyrimeve që burojnë nga zbatimi i MSA përmes adoptimit të *acquis communautaire*, në përputhje me avancimin e Shqipërisë në procesin e integritit evropian.

Është e udhës të sqarohet se procesi i hartimit të dokumenteve të tillë nuk ka filluar dhe as nuk mbaron me Shqipërinë, pasi Programet Kombëtare për Adoptimin e *Acquis*, Programet Kombëtare për Përafrimin e Legjislacionit, Planet e Veprimit në Përgjigje të Partneritetit për Aderim, si dhe Programet Kombëtare të Integritit Evropian, megjithë karakteristikat dhe veçantitë e tyre, në varësi të etapave të ndryshme historike, kanë shërbyer si dokumente planifikues e strategjik të vendeve të përfishra në procesin e integritit evropian. Eksperienca e vendeve kandidate duhet të merret në konsideratë dhe të aplikohet në përputhje me veçoritë e Shqipërisë, pasi procesi i avancimit të Shqipërisë drejt BE-së nuk duhet për asnjë moment t'i nënshtrohet eksperimenteve të pa aplikuar në vende të tjera, të cilat bëjnë që vlera dhe rëndësia e këtyre dokumenteve të humbasë, duke mos u ngulitur në axhendën kombëtare për zhvillimin politik, ekonomik dhe social të vendit.

Është krejt e logjikshme që një plan kombëtar integrimi të ketë fleksibilitetin e nevojshëm për t'iu përshtatur ndryshimeve të kohës, duke shtuar natyrshëm detyrimet që vijnë në rritje me intensifikimin e vetë procesit, duke reflektuar prioritete të qeverive të ndryshme, si pasojë e rotacionit politik, por në thelb duhet të ruhet filozofia dhe qëllimi final i këtij procesi.

Në këtë këndvështrim, Planit Kombëtar për zbatimin e MSA-së do të duhej para së gjithash t'i jepte përgjigje pyetjes se çfarë risie sjell në raport me planin e mëparshëm të miratuar në vitin 2005, përveç adresimit të prioriteteve të reja të Partneritetit Evropian, që duhet të ishte një proces organik, i cili duhet të përfundonte shumë shpejt pas miratimit nga Këshilli i BE-së i dokumentit të Partneritetit Evropian, në mënyrë që vetë Komisioni Evropian, të kishte mundësi të analizonte progresin e Shqipërisë në raport me angazhimet e këtij dokumenti përpara përgatitjes së Raportit Vjetor të vjesh-tës së këtij viti. Përse duheshin shfuqizuar dokumentet ekzistuese të sipërpërmendur? A mos vallë ndryshon filozofia e standardeve europiane përkundrejt zhvillimeve politike të një vendi aspirant, apo janë këto zhvillime që duhen të përshtaten brenda standardeve europiane³?

Nga një vështrim i përgjithshëm, Planit i miratuar së fundmi mbulon të njëjtat çështje të cilat janë trajtuar edhe nga dokumentet e shfuqizuar. Nga krahasimi i dokumenteve, mund të arrihet lehtësisht në përfundimin se pjesët narrative, në shumicë dërrmuese janë të njëjta. Të ndodhur përballë një situatë të tillë, ku si pasojë e shfuqizimit të dokumenteve pararendës dhe mos gjetjes së *nexus* me planin ekzistues një tjetër pyetje kërkon përgjigje: Sa realisht ka rëndësi dhe respektohet përmbajtja e një dokumenti planifikues? Pse e kemi kaq të vështirë t'i njohim procesit politikbërës vazhdimësinë, aq më tepër kur hartimi i dokumenteve të këtij lloji nuk mund dhe nuk duhet bërë pjesë e rivalitetëve partizane, pasi në fund të fundit procesi i integritit evropian dhe hartimit të dokumenteve strategjik në këtë drejtim nuk ka qenë deri më sot një "*bio-process*"!

¹ Shih, "Main Administrative Structures Required for Implementing the

Acquis

", updated: May 2005.

² Rekomandim i rënë dakord ndërmjet palëve në Takimin e 4 të Grupit të Përbashkët Konsultativ BE-Shqipëri (Tiranë, 13-14 Nëntor 2002).

³ Shih, pikën 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për Miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit" e cila thotë:

"Vendimet nr. 634, datë 30.08.2004, "Për miratimin e ~~Planit të Veprimit në zbatim të Përparësive të Partneritetit Evropian~~", dhe nr. 317, datë 13.5.2005, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian dhe zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit", të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen".

Ditmir Bushati

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR MUAJIN KORRIK 2006

1. *P/ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" të ndryshuar", miratuar në seancë plenare më datë 17 korrik 2006.*

Diskutimi i këtij projektligji në komisionet e përhershme të Kuvendit ka zgjatur disa muaj dhe është koordinuar me shqyrtimin e vërejtjeve të palëve të interesuara si OSBE-ja, disa shoqata të ish-pronarëve, institucionet fetare etj. Gjithashtu, deputetët shqyrtuan edhe amendamentet e paraqitura nga Grupi Parlamentar i Partisë Republikane.

Projektligji përbëhet nga 14 amendamente, të cilat kanë si objekt njohjen e të drejtës së pronarëve të shpronësuar sipas ligjit nr.37, datë 13.1.1945 "Ligja e tatimit të jashtëzakonshëm për fitimet e luftës", shtimin e sipërfaqes së tokës bujqësore që i njihet subjektit të shpronësuar, zgjidhjen e marrëdhënieve ndërmjet qiramarrësve dhe ish-pronarëve, duke u dhënë këtyre të fundit të drejtën e parablerjes etj. Sipas këtij projektligji, pronat do të kthehen fizikisht nësa ato janë të lira, ndërsa në rastet kur ato janë të zëna, do të kompensohen me troje në zona turistike, prona në zona të tjera ose do të kompensohen financiarisht në vlerën e tregut.

Diskutimi u zhvillua në frymën e konsensusit midis përfaqësuesve të grupeve të ndryshme parlamentare dhe, mbi këtë bazë, u riformulua ose ndryshua pjesa dërmuese e dispozitave të tij. Një ndër propozimet më të rëndësishme të Grupit Parlamentar të Partisë Republikane, i cili u miratua nga Kuvendi, ishte shkrirja e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe zëvendësimi i tij me Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, me qëllim rritjen e efektivitetit të punës së kësaj strukture dhe të rolit kontrollues të shtetit mbi të.

Çështja për të cilën nuk u ra dakord dhe pati më shumë debat ishte përcaktimi në ligj i kthimit dhe kompensimit të tokës bujqësore deri në 100 ha. Përfaqësuesit e shumicës ishin të mendimit se zgjerimi i sipërfaqes së tokës bujqësore që do t'i kthehet ish-pronarëve nga 60 ha që ishte në ligjin ekzistues, në 100 ha, është i drejtë dhe merr parasysh gjëndjen dhe mundësitë reale të vendit. Përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të Partisë Republikane kërkuan kthimin dhe kompensimin pa kufi të tokës bujqësore, me qëllim që të mos diskriminohen ish-pronarët që zotërojnë mbi 100 ha, aq më tepër kur sipërfaqja që ata zotërojnë është e vogël dhe kostoja e kthimit ose kompensimit të saj është e ulët.

Pas votimit për këtë amendament, Kuvendi miratoi me shumicë votash variantin e propozuar nga Qeveria.

Nga disa deputetë u ngrit shqetësimi që projektligji nuk është shoqëruar me faturën përkatëse financiare. Përfaqësuesit e Qeverisë shpjeguan se është ngritur një grup pune që po kryen inventarizimin dhe evidentimin e sasisë së tokës së lirë, të sasisë së tokës që përbën detyrim

për kthim ose kompensim, si dhe të faturës financiare të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave. Ky proces, shpjeguan ata, kërkon kohën e nevojshme dhe nuk mund të bëhet pengesë për miratimin e projektligjit, i cili përmirëson ligjin ekzistues, duke zgjeruar burimet e kthimit dhe të kompensimit të pronës, si dhe njeh e garanton të drejtat e ish-pronarëve.

Nga deputetët u kërkua përshtypimi i punës së Qeverisë për llogaritjen e faturës financiare dhe për përfshirjen e saj në buxhetin e shtetit.

Pas riformulimit të shumicës së dispozitave të projektligjit, duke marrë në konsideratë pjesën dërmuese të amendamenteve të paraqitura nga Grupi Parlamentar i Partisë Republikane, Kuvendi e miratoi projektligjin.

2. *P/ligjet financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me projektligjin "Për disa ndryshime në ligjin "Për Buxhetin e Shtetit të Vitit 2006""", shqyrtuar në seancë plenare në datat 20 dhe 27 korrik 2006.*

Këto projektligje janë:

a) *P/ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*

Ndryshimet e propozuara synojnë thjeshtimin e procedurave të regjistrimit të tatimpaguesve dhe zvogëlimin e evazionit në derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore.

b) *P/ligji "Për një shtesë në ligjin nr.8981, datë 22.12.2002 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore", i ndryshuar.*

Ky projektligj ka për qëllim respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Ai parashikon heqjen e tarifave doganore për grupmallrat makineri e pajisje, të cilat përdoren në fushën e ndërtimit, bujqësisë, industrisë së lehtë e ushqimore dhe industrisë tekstile. Qëllimi i heqjes së tarifave doganore për këtë grup mallrash është nxitja e investimeve në ekonomi dhe futja e teknologjive të reja e bashkëkohore.

c) *P/ligji "Për një ndryshim në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", i ndryshuar.*

Projektligji ka si objekt rritjen e nivelit të akcizës për artikujt kafe, cigare e pije alkoolike, me qëllim përafrimin e tij me nivelet e vendeve të rajonit e të BE-së, si dhe kompensimin e efekteve negative në buxhet si rrjedhojë e heqjes së tarifave doganore për grupmallrat e përmendura më lart.

ç) *P/ligji "Për një ndryshim në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar.*

Në këtë projektligj propozohet shtyrja me gjashtë muaj e afatit të pagesës së TVSH-së për makineritë e pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, me qëllim rritjen e investimeve në fushën e prodhimit, ndërtimit dhe telekomunikacionit.

(vijon në faqen 9)

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR MUAJIN KORRIK 2006

(vijon nga faqja 8)

d) P/ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ndryshimi që propozohet është reduktimi nga 29 për qind në 20 për qind i masës së kontributit të sigurimeve shoqërore që paguajnë punëdhënësit, me qëllim përfundimin e ngarkesës kontributive të biznesit me atë të vendeve të tjera dhe zvogëlimin e shkallës së informalitetit në deklarin nga biznesi të të punësuarve dhe të masës së kontributit që ata duhet të derdhen në buxhetin e shtetit.

Përfaqësuesit e opozitës shprehën vërejtjet e tyre për këto projektligje, si më poshtë:

- Reforma në administrimin fiskal nuk po kryhet në përputhje me nevojat dhe po pengohet aplikimi i teknologjive të reja në administrimin e tatimeve e taksave.

- Ulja e tarifave doganore nuk po shoqërohet me politika favorizuese për biznesin.

- Rritja e akcizave rrit ngarkesën fiskale ndaj biznesit dhe çmimet ndaj konsumatorit.

- Shtyrja e afatit të pagesës së TVSH-së duhet të jetë jo gjashtë muaj, por një vit, për t'i ardhur në ndihmë biznesit.

Ministri i Financave informoi Kuvendin me rezultatet mjaft pozitive të arritura nga administrata fiskale në mbledhjen e të ardhurave tatimore e doganore, të cilat janë rrjedhojë e rritjes së përgjegjësisë së administratës tatimore e doganore për mbledhjen e të ardhurave dhe për zvogëlimin e evazionit fiskal.

Pas përfundimit të diskutimit, Kuvendi i miratoi projektligjet financiare me shumicë votash.

3. P/ligji "Për disa ndryshime në ligjin nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", shqyrtuar në seancë plenare në datat 25 dhe 28 korrik 2006.

Ky projektligj u prezantua në Komisionin për Ekonominë dhe Financat nga Ministri i Financave, i cili pasqyroi arritjet në realizimin e treguesve të Buxhetit të Shtetit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2006 dhe argumentoi nevojën e ndryshimit të Buxhetit të Shtetit, duke rritur të ardhurat dhe shpenzimet për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2006. Gjithashtu, Ministri paraqiti karakteristikat e projektbuxhetit shtesë dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve për treguesit makroekonomikë dhe për kriteret e shpërndarjes së shpenzimeve shtesë për investime kapitale.

Gjatë diskutimit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare shumica e deputetëve arritën në përfundimin se projektbuxheti shtesë duhet të miratohet nga Kuvendi, pasi ai ka këto karakteristika:

- garanton qëndrueshmërinë e treguesve makroekonomikë të zhvillimit ekonomik të vendit;

- siguron edhe gjatë gjashtëmuajorit të dytë vazhdimësinë e rritjes së të ardhurave të Buxhetit të Shtetit nga burime të qëndrueshme ;

- rrit shpenzimet për investime dhe përmirëson raportin e këtij grupi shpenzimesh ndaj shpenzimeve operative;

- rrit frytshmërinë e investimeve, duke i dhënë përparësi financimit të projekteve publike për infrastrukturën rrugore, furnizimin me ujë dhe me energji elektrike, financimit të projekteve me rëndësi kombëtare, siç është rruga Durrës-Kukës dhe segmente të tjera të aksit jugor, investimeve shtesë në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë etj.

- ruan parametrat e parashikuar të defiçitit buxhetor, duke ulur huamarrjen e brendshme;

- thellon reformën e decentralizimit, duke rritur transfertat për pushtetin vendor;

- pakëson subvencionet publike dhe mbështet politikat aktive kredituese, veçanërisht në sektorin e bujqësisë;

- korrigjon disa tregues të Buxhetit të Shtetit për t'i përafuar me realitetin, siç janë ulja e vlerës së granteve dhe kredive.

Deputetët e opozitës u shprehën kundër miratimit të projektbuxhetit shtesë, duke pretenduar se në të nuk parashikohen fondet e nevojshme për kompensimin e ish-pronarëve, të ish-të përndjekurve dhe për zhvillimin e sektorëve prioritarë. Ata ishin të mendimit se parashikimi i investimeve për 6-mujorin e dytë është i fryrë dhe i përealizueshëm. Gjithashtu, ata u shprehën mosbesues për rritjen e të ardhurave gjatë gjashtëmuajorit të dytë me të njëjtat ritme si në gjashtëmuajorin e parë, për shkak të ndikimit që do të ketë ulja e kontributeve të punëdhënësve për sigurimet shoqërore, ulja e tarifave doganore etj.

Ministri i Financave informoi Kuvendin se parashikimi i fondeve për investime për 6-mujorin e dytë është mbështetur në projektet e hartuara për çdo objekt. Gjithashtu, ai theksoi se tejkalimi i konsiderueshëm i planit të të ardhurave tatimore e doganore gjatë gjashtëmuajorit të parë është një premisë pozitive për rritjen e tyre edhe gjatë gjashtëmuajorit të dytë, si rezultat i punës që po bën Qeveria për të kufizuar evazionin fiskal, kontrabandën e korrupsionin.

Pas përfundimit të diskutimit, projektligji u miratua me shumicë votash.

Ligje te miratuara gjatë punimeve të sesionit të dytë të Kuvendit në Legjislaturën e XVII.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 28.07.06 ka mbyllur punimet e sesionit të dytë të legjislaturës së 17-të. Gjatë këtij sesioni Kuvendi ka miratuar gjithsej 125 ligje të cilat janë të renditur më poshtë duke i klasifikuar në ligje tërësore (jo ndryshime ligjore); Ligje për shtesa dhe ndryshime në ligjet ekzistuese; Ligje për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Aderime.

I. Ligje tërësore (jo ndryshime ligjore).

1. Miratohet dekreti i Presidentit "Për kthimin e ligjit nr. 9482, datë 16.02.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".
2. Ligj nr. 9508, datë 03.04.2006 "Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit".
3. Ligj nr. 9509, datë 03.04.2006 "Për shpalljen e Moratoriumit për mjetet motorike dhe lundruese të Republikës së Shqipërisë".
4. Ligj nr. 9518, datë 18.04.2006 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit".
5. Ligj nr. 9535, datë 15.05.2006 "Për faljen e kamatvonesave të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, të papaguara, të ndërmarrjeve dhe shoqërive, me kapital terësisht shtetëror të ujësjellës - kanalizimeve".
6. Ligj nr. 9537, datë 18.05.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme".
7. Ligj nr. 9572, datë 3.7.2006 "Për autoritetin e mbikëqyrjes financiare".
8. Ligj nr. 9573, datë 3.7.2006 "Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre, të dala jashtë përdorimit ose të braktisura, dhe për veprimtaritë, që lidhen me to".
9. Ligj nr. 9575, datë 3.7.2006 "Për faljen e gjobave të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për personat, juridikë e fizikë, të rregjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, për periudhat tatimore, të vitit 2005".
10. Ligj nr. 9584, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj".
11. Ligj nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit".

12. Ligj nr. 9588, datë 25.07.2006 "Për rillojaritjen e pensioneve".

13. Ligj nr. 9497, datë 20.03.2006 "Për krijimin e Agjencisë Shqiptare të Biznesit dhe Investimeve".

II. Ligje për shtesa dhe ndryshime në ligjet ekzistuese

14. Ligj nr. 9470, datë 02.02.2006 "Për një shtesë në ligjin nr. 8527, datë 23.09.1999 "Për privatizimin e hidrocentraleve vendore".

15. Ligj nr. 9475, datë 09.02.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

16. Ligj nr. 9476, datë 09.02.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8894, datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive".

17. Ligj nr. 9477, datë 09.02.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

18. Ligj nr. 9481, datë 16.02.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9418, datë 20.05.2005 "Për sigurimin suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura të republikës së Shqipërisë".

19. Ligj nr. 9483 datë 16.02.2006 "Për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" të ndryshuar".

20. Ligj nr. 9487, datë 06.03.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9047, datë 10.7.2003 "Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë".

21. Ligj nr. 9491, datë 13.03.2006 "Për një ndryshim në Ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private nismës së lirë të veprimtarisë së pavarur dhe privatizimit", të ndryshuar".

22. Ligj nr. 9494, datë 13.03.2006 "Për një ndryshim në ligjin nr. 12.12.2002 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore" të ndryshuar".

23. Ligj nr. 9498, datë 03.04.2006 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 7703, datë 11/5/1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

24. Ligj nr. 9499, datë 03.04.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

25. Ligj nr. 9506, datë 03.04.2006 "Për një ndryshim në ligjin nr. 8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar".

Ligje te miratuara gjatë punimeve të sesionit të dytë të Kuvendit në Legjislaturën e XVII.

(vijon nga faqja 10)

26. Ligj nr. 9507, datë 03.04.2006 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.9075, datë 29.5.2003 "Për miratimin e kriterëve dhe termave kryesore të zgjidhjes së borxhit të jashtëm të trashëguar, të papaguar të Shqipërisë".

27. Ligj nr. 9512, datë 10.04.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".

28. Ligj nr. 9513, datë 10.04.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve".

29. Ligj nr. 9516, datë 18.04.2006 "Për një ndryshim në Ligjin nr.7918, datë 13.4.1995, "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.2.1995, "Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekëve të privatizimit)", dhe dekretit nr.1049, datë 27.3.1995, "Për disa plotësime në dekretin nr.10.30, datë 23.2.1995", të ndryshuar".

30. Ligj nr. 9517, datë 18.04.2006 "Për një ndryshim në Ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", të ndryshuar".

31. Ligj nr. 9519, datë 18.04.2006 "Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 8464, datë 11.3.1999 "Për standartizimin", të ndryshuar".

32. Ligj nr. 9523, datë 25.04.2006 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.9323, datë 25.11.2004, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik".

33. Ligj nr. 9524, datë 25.04.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese".

34. Ligj nr. 9525, datë 25.04.2006 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7819, datë 27.4.1994 "Për pronësinë industriale, të ndryshuar".

35. Ligj nr. 9529, datë 11.05.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" të ndryshuar".

36. Ligj nr. 9530, datë 11.05.2006 "Për një shtesë në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" të ndryshuar".

37. Ligj nr. 9531, datë 11.05.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar".

38. Ligj nr. 9533, datë 15.05.2006 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor".

39. Ligj nr. 9534, datë 15.05.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9198, datë 1.7.2004 "Për barazinë gjinore në shoqëri".

40. Ligj nr. 9536, datë 15.05.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7667, datë 28.1.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet, që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare".

41. Ligj nr. 9538, datë 22.05.2006 "Për një shtesë në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

42. Ligj nr. 9539, datë 22.05.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8498, datë 10.06.1999 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës, për ndihmë të ndërsjelltë juridike në fushën penale" dhe të protokollit të saj shtesë".

43. Ligj nr. 9540, datë 22.05.2006 "Për një ndryshim në ligjin nr. 9314, datë 11.11.2004 "Për privatizimin e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë".

44. Ligj nr. 9541, datë 22.05.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror".

45. Ligj nr. 9542, datë 22.05.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8996, datë 31.1.2003 "Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (Metrologjinë)".

46. Ligj nr. 9545, datë 29.05.2006 "Për një shtesë në ligjin nr. 8981, datë 12.12.2002 "Për miratimin e niveleve të tarifës doganore" të ndryshuar".

47. Ligj nr. 9546, datë 29.05.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002, "Për akcizat" të ndryshuar".

48. Ligj nr. 9550, datë 01.06.2006 "Për një shtesë në ligjin nr. 8408, datë 25.09.1998 "Për Policinë e Ndërtimit".

49. Ligj nr. 9553, datë 05.06.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8386, datë 30.07.1998 "Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë".

50. Ligj nr. 9558, datë 08.06.2006 "Për një ndryshim në ligjin nr 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit".

(vijon në faqen 12)

Ligje te miratuara gjatë punimeve të sesionit të dytë të Kuvendit në Legjislaturën e XVII.

(vijon nga faqja 11)

51. Ligj nr. 9559, datë 08.06.2006 "Për një shtesë në ligjin nr. 7975, datë 26.07.1995 "Për Barnat narkotike dhe lëndët psikotrope".

52. Ligj nr. 9561, datë 12.06.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme, publike, të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore".

53. Ligj nr. 9567, datë 19.06.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8701, datë 01.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet" të ndryshuar".

54. Ligj nr. 9568, datë 19.06.2006 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e Veteranit të luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", të ndryshuar".

55. Ligj nr. 9570, datë 3.7.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7995, datë 20.09.1995, "Për nxitjen e punësimit" të ndryshuar".

56. Ligj nr. 9574, datë 3.7.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre" të ndryshuar".

57. Ligj nr. 9576, datë 3.7.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8461, datë 25.02.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar".

58. Ligj nr. 9578, datë 11.07.2006 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në marrëveshjen e koncesionit, të formës "BOT" për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës, ratifikuar me ligjin nr. 9298 datë 28.10.2004".

59. Ligj nr. 9580, datë 13.07.2006 "Për një ndryshim në ligjin nr. 8408, datë 25.09.1998 "Për policinë e ndërtimit" të ndryshuar".

60. Ligj nr. 9581, datë 13.07.2006 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8982, datë 12.12.2002, "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar".

61. Ligj nr. 9582, datë 13.07.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8637, datë 06.07.2000 "Për policinë elektrike" të ndryshuar".

62. Ligj nr. 9583, datë 17.07.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

63. Ligj nr. 9585, datë 17.07.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tati-more në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar".

III. Ligje për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Aderime

64. Ligj nr. 9465, datë 19.01.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Çeke, për zgjidhjen e borxhit të Shqipërisë kundrejt Republikës Çeke".

65. Ligj nr. 9466, datë 23.01.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konventës Europiane për ripranimin e personave që qëndrojnë pa autorizim".

66. Ligj nr. 9468, datë 02.02.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin ose kufizimin e përdorimit të armëve të quajtura konvencionale, të cilat mund të konsiderohen se shkaktojnë dëmtime të mëdha ose pasoja pa dallim (Protokolli V)".

67. Ligj nr. 9469, datë 02.02.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane "Programi Vjetor i Veprimit CARDS 2005 për Shqipërinë".

68. Ligj nr. 9472, datë 09.02.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Konventës "Për ndalimin ose kufizimin e përdorimit të armëve të quajtura konvencionale, të cilat mund të konsiderohen se shkaktojnë dëmtime të mëdha ose pasoja pa dallim".

69. Ligj nr. 9473, datë 09.02.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen ndërmjet Republikës së Austrisë, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Çekisë, Republikës së Hungarisë, Republikës së Polonisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Sllovakisë, për mbështetjen e bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë, në kuadër të programit të shkëmbimeve e studimeve universitare për Europën Qëndrore (CEEPUS)".

70. Ligj nr 9474, datë 09.02.2006 "Për ratifikimin e Konventës në kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetësisë "Për kontrollin e duhanit".

71. Ligj nr. 9478, datë 16.02.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në vendimet II/14 dhe III/17,

(vijon në faqen 13)

Ligje te miratuara gjatë punimeve të sesionit të dytë të Kuvendit në Legjislaturën e XVII.

(vijon nga faqja 12)

Amendamentet e Konventës së ESPOO-s “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkuftar”.

72. Ligj nr. 9479, datë 16.02.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë, për mbrojtjen e përbashkët të informacionit të “klasifikuar”.

73. Ligj nr. 9480, datë 16.02.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kopenhagenit, të Protokollit të Montrealit, “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.

74. Ligj nr. 9484, datë 02.03.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Londrës, aneksi II, të Protokollit të MONTREALIT, “Për substancat, që hollojnë shtresën e ozonit”.

75. Ligj nr. 9485, datë 06.03.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Montrealit, të Protokollit të Montrealit, “Për substancat, që hollojnë shtresën e ozonit”.

76. Ligj nr. 9486, datë 06.03.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Pekinit, të Protokollit të Montrealit, “Për substancat, që hollojnë shtresën e Ozonit”.

77. Ligj nr. 9488, datë 13.03.2006 “Për ratifikimin e Protokollit shtesë të Konventës Europiane “Për informimin për të drejtën e huaj”.

78. Ligj nr. 9489, datë 13.03.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në dispozitat për zhvillimin, pranimin dhe zbatimin e kërkesave të përbashkëta të aviacionit”.

79. Ligj nr. 9490, datë 13.03.2006 “Për ratifikimin e Konventës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, jomatere, Paris, 2003”.

80. Ligj nr. 9492, datë 13.03.2006 “Për ratifikimin e konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit”.

81. Ligj nr. 9493, datë 13.03.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigjianssa, S.P.A për financimin e programit “Për pesë poliklinika në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçë dhe Peshkopisë”.

82. Ligj nr. 9495, datë 20.03.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për shpëtimin, Londër, 28 prill 1988”.

83. Ligj nr. 9496, datë 20.03.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Repub-

likës së Shqipërisë dhe Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), për transferimin e personave të dënuar”.

84. Ligj nr. 9500, datë 03.04.2006 “Për ratifikimin e Protokollit shtesë, për luftën kundër terrorizmit, të marrëveshjes ndërmjet qeverive të shteteve pjesëmarrëse të bashkëpunimit ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht në format e organizuara të tij”.

85. Ligj nr. 9501, datë 03.04.2006 “Për ratifikimin e traktatit të Krijimit të Komunitetit të Energjisë”.

86. Ligj nr. 9502, datë 03.04.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së shqipërisë dhe Artigiancassa S.P.A. për financimin e programit “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta të Tiranës”.

87. Ligj nr. 9503, datë 03.04.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Kontratën e Transportit Rrugor Ndërkombëtar të mallrave (CMR) dhe Protokollin e nënshkrimit”.

88. Ligj nr. 9504, datë 03.04.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për transportin e mallrave me rrugë detare, (Rregullat e Hamburgut)”.

89. Ligj nr. 9505, datë 03.04.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Ministror të Konfederatës Zvicerane, për bashkëpunimin policor në luftën kundër krimit”.

90. Ligj nr. 9510, datë 10.04.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa, S.P.A. për financimin e programit “Periferitë Urbane të Tiranës - komponenti infrastrukturor”.

91. Ligj nr. 9511, datë 10.04.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen Europiane “Për arteriet kryesore të trafikut ndërkombëtar (AGR)”.

92. Ligj nr. 9514, datë 18.04.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrveshjen Europiane “Për punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor (AETR) dhe në Protokollin e nënshkrimit e në Amendamentin nr. 4 të saj”.

93. Ligj nr. 9515, datë 18.04.2006 “Për zbatimin e konventës “Për ndalimin e përdorimit, të magazinimit, të

(vijon në faqen 14)

Ligje te miratuara gjatë punimeve të sesionit të dytë të Kuvendit në Legjislaturën e XVII.

(vijon nga faqja 13)

prodhimit dhe të transferimit të minave kundër personit (MKP) dhe për shkatërrimin e tyre”.

94. Ligj nr. 9520, datë 25.04.2006 ”Për ratifikimin e marrëveshjes financiare shtesë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e Fondi i Zhvillimit Shqiptar, si Agjenci e Zbatimit të projektit, dhe Kreditanstalt FÜR ËIEDERAUFBAU (KFË), të marrëveshjes së financimit të projektit “Fondi i Investimeve Sociale - II”.

95. Ligj nr. 9521, datë 25.04.2006 ”Për ratifikimin e një ndryshimi në Protokollin e Anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Marrakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë”.

96. Ligj nr. 9522, datë 25.04.2006 ”Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe të shkencës”.

97. Ligj nr. 9526, datë 11.05.2006 ”Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillimin Ndërkombëtar, për projektin e spitalit të Kavajës”.

98. Ligj nr. 9527, datë 11.05.2006 ”Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane, për realizimin e programit për zhvillimin e sektorit privat, me anën e një kredie ndihme, për mbështetjen e ndërmarrjeve, të vogla dhe të mesme, si dhe sigurimin e asistencës teknike për to”.

99. Ligj nr. 9528, datë 11.05.2006 ”Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa, S.P.A ”Për Programin e Zvillimit të Sektorit Privat, nëpërmjet mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sigurimit të asistencës teknike për to”.

100. Ligj nr. 9532, datë 15.05.2006 ”Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Strazburgut, për klasifikimin ndërkombëtar të patentave, 1979”.

101. Ligj nr. 9543, datë 29.05.2006 ”Për ratifikimin e marrëveshjes së sigurisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për mbrojtjen e ndërsjelltë të informacionit të klasifikuar”.

102. Ligj nr. 9544, datë 29.05.2006 ”Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve, viktimat të trafikimit”.

103. Ligj nr. 9547, datë 01.06.2006 ”Për ratifikimin e Konventës nr. 168, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, “Për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen nga papunësia, 1988”.

104. Ligj nr. 9548, datë 01.06.2006 ”Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin për regjistrat e shkarkimit dhe të transferimit të ndotësve”.

105. Ligj nr. 9549, datë 01.06.2006 ”Për ratifikimin e Marrëveshjes së Grantit të Objektivit Strategjik, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të luftuar korrupsionin, në kuadër të programit fillestar të vlerësimit të sfidës së mijëvjeçarit”.

106. Ligj nr. 9551, datë 05.06.2006 ”Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për Garancitë Ndërkombëtare në paisjet e lëvizshme” dhe në Protokollin e saj”.

107. Ligj nr. 9552, datë 05.06.2006 ”Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen “Për privilegjet dhe Imunitetet e Gjykatës Ndërkombëtare Penale”.

108. Ligj nr. 9554, datë 08.06.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, në fushën civile dhe tregtare”.

109. Ligj nr. 9555, datë 08.06.2006 ”Për ratifikimin e Konventës Europiane “Për statusin ligjor të punëtorëve migrantë”.

110. Ligj nr. 9556, datë 08.06.2006 ”Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit “Rehabilitimi i Portit të Vlorës”.

111. Ligj nr. 9557, datë 08.06.2006 ”Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen kuadër për bashkëpunimin, ndërmjet shteteve Frankofone të Europës Qëndrore dhe Lindore, për zhvillimin e formimit profesional dhe teknik”.

(vijon në faqen 15)

Ligje te miratuara gjatë punimeve të sesionit të dytë të Kuvendit në Legjislaturën e XVII.

(vijon nga faqja 14)

112. Ligj nr. 9560, datë 12.06.2006 "Për ratifikimin e Amendamentit të Dispozitive, që lidhen me Tregtinë, të Traktatit të Kartës së Energjisë".

113. Ligj nr. 9563, datë 19.06.2006 "Për ratifikimin e disa ndryshimeve në Kushtetutën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë".

114. Ligj nr. 9564, datë 19.06.2006 "Për ratifikimin e Konventës nr. 143 "Për punëtorët migrantë (dispozitë plotësuese), 175" të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, bërë në Gjenevë".

115. Ligj nr. 9565, datë 19.06.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Estonisë, për mbrojtjen e ndërsjelltë të informacionit të klasifikuar".

116. Ligj nr. 9566, datë 19.06.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës së Industrive Gjermane (BDI)/(IFG), që veprojnë në emër të kreditorëve gjermanë, për riskludimin e borxhit të prapambetur, kundrejt kreditorëve gjermanë, të pagarantuar nga Qeveria Federale e Gjermanisë".

117. Ligj nr. 9569, datë 3.7.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës, për transportin ndërkombëtar rrugor".

118. Ligj nr. 9571, datë 3.7.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, "Për programin rajonal CARDS 2005".

119. Ligj nr. 9577, datë 11.07.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Repub-

likës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Letonisë, për transportin ndërkombëtar rrugor".

120. Ligj nr. 9579, datë 11.07.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së financimit ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillimin (IDA), për projektin "Modernizimi i sistemit shëndetësor".

121. Ligj nr. 9586, datë 20.07.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për aspekte të caktuara të shërbimeve ajrore".

122. Ligj nr. 9589, datë 25.07.2006 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit "Zhvillimi i rrugëve në Bashkinë e Tiranës".

IV. Ligje për miratimin e akteve me fuqinë e ligjit.

123. Ligj nr. 9467, datë 30.01.2006 "Për miratimin e Aktit Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 13.12.2005 "Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën" të ndryshuar".

124. Ligj nr. 9471, datë 06.02.2006 "Miratohet Akti normativ nr. 5 datë 28.12.2005 me fuqinë e ligjit "Për dërgimin e personelit ushtarak shqiptar, në përbërje të shtabit të SEEBRIG-ut, në misionin e mbështetjes së paqes (ISAF), në Afganistan të drejtuar nga NATO".

125. Ligj nr. 9562, datë 19.06.2006 "Për miratimin e Aktit Normativ nr. 1, datë 9.6.2006 "Për njohjen e Republikës së Malit të Zi".

| | |
|---|--|
| Bashkëpunëtorë për marrjen e informacionit mbi veprimtarinë e Qeverisë dhe të Kuvendit | Alma Kondakçiu Ditmir Bushati Denis Gila Filip Lako |
| Stafi i Projektit | Sokol Berberi Denada Breshanaj Milaim Demnushaj |

Qendra e Studimeve Parlamentare
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tiranë-Shqipëri Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org

| | |
|--|--|
| Collaborators for the information on Government and Assembly activities | Alma Kondakçiu Ditmir Bushati Denis Gila Filip Lako |
| Project Staff | Sokol Berberi Denada Breshanaj Milaim Demnushaj |

Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214;
cps@albaniaonline.net;
www.ascdp.org